
KËRKESË

KËRKUES:**OBJEKTI:** Kërkesë për informacion**Baza ligjore:** Neni 12 i ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.**DREJTUAR:** **AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**, me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, Kodi postar 1001, Tiranë

Të nderuar!

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Penale) është regjistruar kërkesa penale e vitit 2025, që u përket palëve:

I dëmtuar akuzues: Alaudin Malaj

I akuzuar: “valanews.al”

Objekti: Kërkesë për gjykim për portalit “valanws.al” për kryerjen e veprës penale të “Shpifjes”.

Duke qenë se nga ana e personave përgjegjës për menaxhimin e këtij portali nuk është vendosur në dispozicion asnjë adresë apo numër telefoni për të mundësuar kontaktin me to, ju drejtohem ju si autoriteti kombëtar i caktuar me ligj për mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve elektronike si dhe administron domainin “.al”, përmes kësaj shkrese për të kërkuar nga ana juaj informacionin si më poshtë:

- A është i regjistruar rregullisht në domainin zyrtar “.al” subjekti: Portali Informativ Shqiptar “valanews.al”?
- Nëse po, ju lutem të na vendosni në dispozicion një adresë fizike dhe ose/numër zyrtar të kontaktit të tyre telefonik.

Informacioni i mësipërm është i domosdoshëm për vijimin e gjykimit të sipërcituar dhe për këtë arsye do t’ju lutesha të ma vendosni në dispozicion në një kohë sa më të shpejtë.

Duke ju falënderuar,

KËRKUESE